

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet e rezervës së naftës: Shqipëria krijon asetin strategjik për rastet e krizave
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/23/detajet-e-rezerves-se-naftes-shqiperia-krijon-asetin-s-trategjik-per-rastet-e-krizave/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:50:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 07:47:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c4e32605ebf334390a513702fe78ee8af1c67ae5d440eeea7e68c1e3cc657b8
TEKSTI	7ecaecf59277c4aee110631e31903786575ff0f73544f151d1537a502b5a4f7b
PAMJA	c0e8dfb25f77099f245709cad81dd3603a7c1397e19b65b64f7f1d7a5bc23b91

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f22b69f48e60fd5eded5b76a580b12ebfea8675de0028d7476ba19998eb8a22e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f22b69f48e60fd5eded5b76a580b12ebfea8675de0028d7476ba19998eb8a22e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Detalet e rezervës së naftës: Shqipëria krijon asetin strategjik për rastet e krizave

Ekonomi

Publikuar: 23/09/2026

f X



Shqipëria do të ndryshojë mënyrën se si garanton furnizimin me karburante në rast krizash, duke krijuar gradualisht një rezervë strategjike të naftës dhe nënprodukteve të saj, e cila do të menaxhohet përmes një autoriteti të posaçëm. Në Kuvend është depozituar nisma ligjore që parashikon një model të ri që synon që vendi të ketë në dispozicion karburant edhe në rast të ndërprerjeve të papritura të importeve apo problemeve serioze në tregjet ndërkombëtare.

Projektligji i hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përcakton që rezerva minimale duhet të jetë e barabartë me të paktën 90 ditë të importeve mesatare ditore neto ose 61 ditë të konsumit mesatar ditor të brendshëm, duke u marrë për bazë sasia që rezulton më e madhe. Rezerva nuk do të krijohet menjëherë, por gradualisht, sipas një plani veprimi që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimi kryesor lidhet me mënyrën e administrimit. Aktualisht, detyrimi për mbajtjen e rezervave bie mbi rafineritë dhe kompanitë e tregtimit me shumicë, të cilat prej vitit 2011 kanë detyrimin që të mbajnë rezerva të barabarta me 90 ditë mesatare shitjeje. Me skemën e re parashikohet ngritja e Autoritetit për Rezervën e Sigurisë, i cili do të blejë, shesë dhe administrojë stokun strategjik. Rezervat mund të ruhen në kapacitetet e Autoritetit ose në depo të operatorëve privatë të kontraktuar prej tij.

Krijimi i stokut do të ketë një kosto të konsiderueshme. Modeli financiar i përfshirë në relacion parashikon për periudhën 2026–2030 blerjen e rreth 43,600 tonëve karburante, me një kosto të vlerësuar prej rreth 39.4 milionë eurosh për blerjen dhe 2.6 milionë euro për depozitimin, ose rreth 42 milionë euro gjithsej.

Me të lexuarat

Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë 500 mijë /

“Do përfundojmë keq shpirt”. Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te

Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tandra n...

Te gjithë e dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te

Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

Stoku i parashikuar në këtë model përbëhet nga 17,440 ton naftë bruto, 13,080 ton diesel, 8,720 ton benzinë, 2,180 ton karburant avionësh dhe 2,180 ton LPG. Kjo do të thotë se rezerva strategjike nuk do të përbëhet vetëm nga nafta bruto, por edhe nga produktet që mund të përdoren drejtpërdrejt nga tregu në rast nevojë.

Rezervat do të ruhen nën një regjim të posaçëm sigurie. Ato duhet të jenë në çdo moment fizikisht të disponueshme dhe të aksesueshme dhe nuk mund të përdoren si kolateral, të vendosen nën hipotekë apo peng, apo të jenë objekt i kufizimeve që do të pengonin përdorimin e menjëhershëm të tyre.

Për kontrollin e stokut do të krijohet edhe Regjistri Kombëtar i Rezervave të Sigurisë, ku do të regjistrohen vendndodhja e kapaciteteve të depozitimit, kapacitetet dhe sasi të ruajtura. Të dhënat do të administrohen nga Autoriteti në bashkëpunim me INSTAT-in dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në rast të një ndërprerjeje të rëndë të furnizimit, rezervat do të mund të nxirren në treg për të garantuar furnizimin e ekonomisë. Vendimi për përdorimin e tyre do të merret nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me mekanizmin kombëtar të reagimit ndaj krizave.

Ndryshimi lidhet edhe me procesin e integritetit europian. Shqipëria synon të përafrojë sistemin me direktivën europiane për rezervat minimale të naftës. Sipas relacionit, krijimi i sistemit të ri synon të sjellë modelin shqiptar në linjë me kërkesat e Bashkimit Europian dhe Komunitetit të Energjisë.

SCAN TV

TAG:

Nafta

rezerva

Shqipëria

Të ngjashme



Euro vijon "rrrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve



Bordi ul me 6 lekë çmimin e naftës, do të shitet me 213 lekë/litri! Benzina shkon në 193 lekë/litri



SEPA nxit remitancat, BSH: Ulja e kostove ka shtuar dërgesat e emigrantëve

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë edhe kështu ligjore. Injektiv

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

dhe munda të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.